

Përmbledhje

1. **Emri i Trajnimit** : “ Përfshirja qytetare në vendimmarrjen publike”
2. **Data e trajnimit**: 27/03/2017
3. **Qyteti ku u zhvillua trajnimi** : Patos
4. **Vendi ku u zhvillua trajnimi**: Salla e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak
5. **Trajner**: Esmeralda Kararaj, Drejtoresha e Kabinetit, Bashkia Patos
6. **Qellimi dhe objektivat e trajnimit** : Informimi mbi mekanizmat për pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrjen lokale, kuadri ligjor ku rregullohet e drejta e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje.
7. **Pasqyrë mbi pjesëmarrësit**

Nr. i pjesëmarrësve	8
Pozicioni	Këshilltar, Përgjegjësja e Sektorit të Informacionit, Specialistja e Barazisë Gjinore, Specialiste informacioni, Topograf, Juriste, Financiere, Koordinator I Komisionit Këshillimor Qytetar Vendor
Gjinia	6 femra dhe 2 meshkuj
Reagimi i pjesëmarrësve	Shumë aktivë

8. **Diskutimet kryesore nga pjesëmarrësit :**

- Komisioni Këshillimor Qytetar Vendor, i përbërë nga 18 anëtar me pjesëmarrje të barabartë të meshkujve dhe femrave.
- Praktikat ku qytetarët janë dëgjuar dhe kanë ndikuar në vendimmarrje janë çështjet lidhur me investimin dhe infrastrukturën.
- Sistemi i pastrimit të kanaleve i arritur pas 25 vjetësh, për njësinë administrative të Zharrës.
- Praktikat e ndjekura nga Bashkia Patos për informimin qytetarëve:
 Faqja në rrjetin social të facebook-ut, rezulton një mjet efektiv informimi pasi qytetarët japin feedback-un e tyre nëpërmjet komenteve lidhur me informacionet e publikuara.
 Prezantime në powerpoint në pallatin e kulturës me gjithë pjesëmarrje të qytetarëve

Ditën e hënë, më datë 27.03.2017, u zhvillua në Bashkinë Patos, trajnimi mbi “Pjesëmarrjen Qytetare, në Vendimmarrjen Publike” me pjesëmarrës punonjës të bashkisë si këshilltare për njësinë administrative të Zharrës, Përgjegjësja e Sektorit të Informacionit, Specialistja e Informacionit, Specialistja e Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje, Juriste, Financiere, Topografi dhe Koordinator i Komisionit Këshillimor Qytetar Vendor.

Trajnimi u përqendrua në shembujt nga bota dhe praktikat e mira si dhe parimet dhe dispozitat kushtetuese nga e cila, buron kjo e drejtë.

Pjesëmarrësit në trajnim ishin shumë aktivë dhe të angazhuar në diskutime, për teknikalitete të sektorit teknologjik faqja zyrtare e Bashkisë Patos, nuk ishte e përditësuar me informacion por po punohej për rregullimin e saj dhe ngarkimin e informacionit të duhur në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

